



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Kamëz, më 02 / 10 2025

NJOFTIM!

Referuar ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore";

Ju sqarohet se:

Njoftohen të gjithë qytetarët e interesuar të paraqesin aplikimet e tyre online në platformën e-albania për programin social të strehimit "Subvencionimi Interesave të Kredisë" në Bashkinë Kamëz nga data 03/10/2025 (*Faza e Parë*).

Programi Social i Strehimit për "Subvencionimin e Interesave të Kredisë" synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e tyre të jetesës.

Kriteret bazë për paraseleksionimin e kërkesës së paraqitur nga individët/familjet e interesuara për të përfituar nga programi social strehimit për "Subvencionimin e Interesave të Kredisë" janë:

- Individët të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë mbushur moshën 18 vjec;
- Familjet të cilat në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kanë në pronësi një banesë;
- Familjet që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit bazuar në ligjin 22/2018 "Për Strehimin Social".
- Familjet që zotërojnë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.1 – Kufiri maksimal i kredisë të përfituesve potenciale:

Struktura familjare	Struktura apartamentit	Kufiri maksimal i kredisë/familje
1	Garsonier	2,814,750
2	1+1	3,440,250
3-4	2+1	5,066,550
MBI 5	3+1	6,255,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Nga programi i Subvencionimit të Interesave të Kredisë do të përfitojnë ato familje/individë që nuk disponojnë banesë në pronësi. Përparësi në përzgjedhje do të kenë:

- Familjet e reja dhe të rinj me moshë deri në 40 vjeç;
- Familje me më shumë se katër fëmijë;
- Familje njëringërore që kanë në ngarkim fëmijë;
- Gra kryefamiljare/gra të dhunuara.

Përparësitë e përcaktuara më sipër nuk përjashtojnë individë a familje që nuk bëjnë pjesë në këto familje. Çdo individ/familje mund t'i drejtohet të treja bankave për të marrë ofertën që i përshtatet më mirë kushteve të tij/saj dhe në pas të vijojë me bankën që përzgjedh vetë.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin

DREJTORI

Touta CAMI